

**Nr. Prot. 058/B/17****VENDIM Nr. 1058****Për  
Fillimin e Procesit të Konsultimit Publik  
për  
Draft****“Rregulloren për Shërbime Universale të Komunikimeve Elektronike”**

Në mbështetje të nenit 1, nenit 10, paragrafi 4), nenit 28 paragrafi 1) paragrafi 2) dhe paragrafi 5), nenit 79, paragrafi 1) dhe 2) dhe nenit 82 paragrafi 1) dhe paragrafi 2) i Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike (*tutje referuar si - Ligji*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- |                      |                  |
|----------------------|------------------|
| 1) z. Kreshnik Gashi | Kryetar i Bordit |
| 2) z. Nijazi Ademja  | Anëtar i Bordit  |
| 3) z. Hazir Hajdari  | Anëtar i Bordit  |
| 4) z. Bahri Anadolli | Anëtar i Bordit  |
| 5) z. Shqiprim Pula  | Anëtar i Bordit  |

në mbledhjen e 22-të me radhë të mbajtur më datë 18 tetor 2017, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga DKE dhe DL, unanimisht morri këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik për draft “**Rregulloren për Shërbime Univerzale të Komunikimeve Elektronike**”.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë: **24 Tetor 2017** dhe përfundon më datë **23 Nëntor 2017**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Neni 28 paragrafi 5 i Ligjit përcakton që: *“Autoriteti miraton rregullat për përcaktimin e shërbimit universal si dhe të përcaktojë fushëveprimin e shërbimeve universale, kërkesat e kualitetit të shërbimit, procedurën dhe kushtet për ofrimin e shërbimit të tillë, procedurën, kushtet dhe rastet për imponimin e detyrimeve të shërbimit universal për ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike. Detyrimet e shërbimit universal gjithashtu mund të lidhen me të qenurit operator me fuqi të ndjeshme tregu në një treg relevant.”*

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikojë ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Duke pas parasyshë atë që u tha më lartë u vendos sikurse në dispozitiv të këtij vendimi..

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 24/10/2017**

#### **Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik/Departamenti i Postë Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informative;
- Departamentit Ligjor, ARKEP
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP;
- Arkivit, ARKEP